

Rruga Dixhitale - Raport Shkurt 2022

ID	Kontrata	Hapur me	Tipi	Burimi	Pershkrimi i Problemit	Lokacioni	Statusi	Mbyllur me	Pershkrimi i Zgjidhjes
409203	CC	2/3/2022	Ankimim	Bashkeqeverisja	<p>Pershendetje! Ju shkruaj per te disaten here ne lidhje me aksin rrugor Elbasan-Cerrik. Ky aks ka degraduar ne shume pjese te tij dhe eshte bere i rrezikshem per levizjen e automjeteve.</p> <p>Gjithashtu ne uren e shkumbinit ndricimi ka kohe qe nuk funksionon dhe ne fshatin Kuqan Elbasan ndricimi ne disa shtylla ne eshte nderprere. Probleme te medha ka asfalti ku eshte ngritur ne shume pjese te rruges. Me problematike eshte ne hyrje te fshatit Shirgjan dhe Gjergjan. Per me shume detaje jam i hapur te me kontaktoni. Faleminderit!</p>	Kuqan	Te zgjidhura	2/24/2022	<p>Pershendetje, Ne vijim te anekses te z. Demiri, kontraktori i mirembajtjes ka kryer inspektimin ne terren dhe nga vleresimi i bere rezulton se:</p> <p>shtresat e paketes asfaltike jane te demtuar dhe kerkojne nderhyrje te thelle. Ne kete segment kryehet vetem mirembajtja rutinore dhe nderhyrja e kerkuar nuk mund te realizohet ne kuader te ketij sherbimi, ndersa per sa i perket ndricimit, kontraktoritit i nevojitet nje kohe me e gjate per identifikimin dhe riparimin e problemeve elektrike. Aktualisht po punohet per ti dhene zgjidhje problemit te sipercituar.</p>
543429	CC	2/4/2022	Kerkese	Email	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kush është kompania që mirëmban rrugën Elbasan-Librazhd? 2. Kur e ka fituar tenderin? 3. Sa ka qënë fondi limit dhe sa ka ofruar ajo? 4. Për sa kohë e ka marrë mirëmbajtjen e rrugës? 5. Cfarë përmban kontrata? 	Elbasan - Librazhd	Te zgjidhura	2/24/2022	<p>Ne vijim te informacionit te kerkuar nga....., ju sqarojem si me posht vijon:</p> <p>Kush është kompania që mirëmban rrugën Elbasan-Librazhd?</p> <p>Kompania e cila miremban segmentin rrugor Elbasan - Librazhd eshte "Rawafed Al-Torok Contracting Establishment"</p> <p>Kur e ka fituar tenderin? Kontrata ndermjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Operatorit Ekonomik eshte firmosur me 23.02.2017.</p> <p>Sa ka qënë fondi limit dhe sa ka ofruar ajo? Vlen per tu theksuar se prokurimi i kesaj kontrate eshte bere sipas procedurave te prokurimit te Bankes Boterore ku fondi limit nuk percaktohet per tenderuesit, keta te fundit japin oferten e tyre bazuar ne specifikimet teknike dhe kerkesat e prezantuara nga Autoriteti Kontraktor. Vlerat jane publike ne faqen zyrtare te BB.</p> <p>Për sa kohë e ka marrë mirëmbajtjen e rrugës? Mirembajtja e ketije segmenti rrugor eshte parashikur te kryhet me ane te kesaj kontrate nga data e nenskrimit te kontrates deri me 31.03.2022.</p>

Rruga Dixhitale - Raport Shkurt 2022

ID	Kontrata	Hapur me	Tipi	Burimi	Pershkrimi i Problemit	Lokacioni	Statusi	Mbyllur me	Pershkrimi i Zgjidhjes
485359	CB	2/7/2022	Kerkese	Email	<p>Kërkesë për dhënie informacioni</p> <p>Në bazë të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në cilësinë e gazetarit, po ju drejtohem për të kërkuar informacion në lidhje me aksin rrugor nacional Skuraj – Burrel. Në shkurt të vitit 2017 është lidhur një kontratë mirëmbajtjeje për këtë aks rrugor me firmën "Geci & Bioliap" e cila përfundon për pak ditë. Duke parë gjendjen në të cilën po dorëzohet kjo rrugë, kërkoj nga ana juaj të më vihen në dispozicion:</p> <p>1 – Kontrata e mirëmbajtjes bashkë me anekset, e lidhur midis jush dhe frimës mirëmbajtëse 5 vite më parë.</p> <p>2 – Preventivat e punimeve të kryera gjatë kësaj periudhe për këtë segment rrugor dhe gjithë lotin 2 që përfshin projekti në fjalë.</p> <p>3 – Kush do ta mirëmbajë këtë rrugë pas përfundimit të kontratës?</p> <p>Lutem që informacioni i kërkuar të shoqërohet me dokumentacion!</p>	Skuraj-Burrel	Te zgjidhura	2/21/2022	<p>Aneket e kontrates për mirëmbajtjen rutinë dhe punimet e emergjences, me vlerat respektive.</p> <p>Specifikimet teknike për shërbimin e mirëmbajtjes rutinë Pika B.1.1.3.</p> <p>Punimet e emergjences të realizuara për këtë segment rrugor (kryesisht për riparimin e mureve mbajtës, shtresave asfaltike dhe sinjalistikes rrugore):</p> <ul style="list-style-type: none"> · Emergjencia B.1, "Rikonstruksioni i rrugës, përfshirë rikonstruksionin e murit mbajtës të dëmtuar", segmenti Skuraj (Rotondo)- Komuna Baz, km 1+325, vlerë = € · Emergjencia B.2, "Rikonstruksioni i rrugës, përfshirë rikonstruksionin e urës dhe murit mbajtës të dëmtuar" segmenti Skuraj (Rotondo)- Komuna Baz, km 17+550, vlerë = € · Emergjencia B.3, "Rikonstruksioni i rrugës, përfshirë rikonstruksionin e murit mbajtës të dëmtuar", segmenti K/Dalje Burrel- Qendër qyteti Klos, km 7+25, vlerë = € · Emergjencia B.4, "Rikonstruksioni i rrugës, përfshirë rikonstruksionin e murit mbajtës të dëmtuar", segmenti Komuna Baz- K/Unaza hyrje Burrel, km 8+850, vlerë= € · Emergjencia B.5, "Rikonstruksioni i rrugës, përfshirë rikonstruksionin e murit mbajtës të dëmtuar dhe të kanalit të kullimit", segmenti Komuna Baz- K/ Hyrje Burrel, km 10+625, vlerë= € · Emergjencia B.8, "Rikonstruksioni i rrugës, përfshirë rikonstruksionin e murit mbajtës të dëmtuar", segmenti Skuraj (Rotondo)- Komuna Baz, km 21+325, vlerë= 1..... € · Emergjencia B.9, "Rikonstruksioni i rrugës, përfshirë rikonstruksionin e murit mbajtës të dëmtuar", segmenti Komuna Baz- K/ Hyrje Burrel, km 2+020, vlerë= € · Emergjencia B.12, "Ndërtimi i murit mbajtës të dëmtuar dhe rikonstruksioni i shtresave rrugore", segmenti Skuraj (Rotondo)- Komuna Baz, km 19+875, vlerë= € · Emergjencia B.13, "Rikonstruksioni i murit mbajtës të dëmtuar", Komuna Baz- K/ Hyrje Burrel, km 9+950, vlerë= 28,870.02 € · Emergjencia B.16, segmenti Skuraj Komuna Baz/ Punime per sigurinë
424858	Not ARA	2/16/2022	Ankimim	Bashkeqeverisja	<p>Rruga Rreshen-Burrel totalisht e amortizuar. 1.3 miliardë lek të shkuara dem. Turp t ju vije per cilesine e punimeve. Te pakten gropat mbushini me beton se maksimumi 20 betoniere duhen qe si kapin as 2.5 milion leke vlere. 2.5 milione lek ju i keni sa per kafe keshtu qe merreni ne shqyrtim.</p>	Rreshen - Burrel	Te zgjidhura	2/7/2022	not ARA contract/project

Rruga Dixhitale - Raport Shkurt 2022

ID	Kontrata	Hapur me	Tipi	Burimi	Pershkrimi i Problemit	Lokacioni	Statusi	Mbyllur me	Pershkrimi i Zgjidhjes
417052	CB	2/18/2022	Ankimim	Komisariati Dixhital	Vendosje e ekрани reklamimi ne rruge autostrade ne kundershitim me kodin rrugor neni 23 reklammat ne rruge dhe mbi mjetet rrugore. Eshte burim aksidenti.	Mbikalimi Kashar	Te zgjidhura	2/18/2022	<p>Përsëhendetje !</p> <p>Në vijim të ankesës së paraqitur në portalin "Komisariati Dixhital" Nr 55213, date 17.02.2022, ne lidhje me vendosje ekрани reklamimi ne rruge, me adrese "Mbikalimi i Kasharit tek rruga qe te con tek Megatek, ngjitur me karburant Alpet", ju sqarojme si më poshtë:</p> <p>Vendodhja e objektit të mësipërm është në anë të korsisë hyrëse të rrugës së Megatek, e cila nuk bën pjesë në trupin e rruges se autostrades (eshte jashte zones dhe kompetences tone). Në këto kushte kjo anekse nuk mund të trajtohet nga ana jonë.</p> <p>Faleminderit.</p> <p>er sa i perket pikes nr 4 ju sqarojme si me poshte vijon:</p>
425596	CC	2/20/2022	Kerkese	Bashkeqeverisja	<p>Kërkesë</p> <p>Duke marre para sysh disa ankesa te bera nga une me pare ne lidhje me degradimin e rruges Elbasan-Cerrik te cilat nuk kane marre zgjidhje deri tani, dua te kem informacion mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kontraten e kryer me dy kompanite qe kane ndertuar rrugen ne lotin 1 edhe 2, perkatesisht Gjoka Konstruksion dhe Hysa SHPK Shumën totale te shpenzuar për ndertimin e rruges net e dy lotet e saj. Relacionin perfundimtar nga vezhguesi i punimeve te kesaj rruge Kontraten me kompanine mirembajtese aktuale te rruges duke perfshire dhe pagesen qe kjo kompani perfiton nga mirembajtja e kesaj rruge. 	Elbasan - Cerrik	Te zgjidhura	2/25/2022	<p>4. Kontraten me kompanine mirembajtese aktuale te rruges duke perfshire dhe pagesen qe kjo kompani perfiton nga mirembajtja e kesaj rruge.</p> <p>Autoriteti Rrugor Shqiptare ne kuader te projektit "Mirembajtja dhe Siguria Rrugore Bazuar ne Rezultate" (RRMSP) ka nenshkuar kontraten Nr1475 Prot, me date 23.02.2017 me operatorin ekonomik "Rawafed Al-Torok Contracting Establishment".</p> <p>Segmenti rrugor "Ura e Shkumbinit deri me Kryqezimi Yll Cerrik" eshte bere pjese e mirembajtjes rutine sipas kesaj kontrate mbas firmosjes se Urdherit te Punes.</p> <p>Per sa i takon pjese se pageses qe kontraktori perfiton nga mirembajtja e kesaj rruge vlene te theksohet se duke ju referuar Kushteve te Pergjithshme te Kontrates pika 15.1 Punedhenesi dhe Kontraktori duhet te mbaje konfidenciale dhe nuk duhet, pa mare miratimin me shkrim nga pala tjeter te shperndajen informacion ne lidhje me kontraten. Per kete arsyje dhe ne munges te kesaj marrveshje mes paleve nuk eshte e mundur nga ana e jone tju vihet ne dispozicion ky informacion. (pjese nga teksti ne gjuhen angleze sipas kontrates "15. Confidential Information 15 .1 The Employer and the Contractor shall keep confidential and shall not, without the written consent of the other party hereto, divulge to any third party any</p>

Rruga Dixhitale - Raport Shkurt 2022

ID	Kontrata	Hapur me	Tipi	Burimi	Pershkrimi i Problemit	Lokacioni	Statusi	Mbyllur me	Pershkrimi i Zgjidhjes
426604	CB	2/24/2022	Ankimim	Bashkeqeverisja	<p>Pershendetje ! Jam banor i njesise adminastrative Sinaballaj bashkia Rrogozhine . Ankesa ime eshte se hyrje te fshatit barrierat mbrojtese jane vendosur ne menyre te atille qe rruga eshte shume e ngushte . Ju lutem mund ti zgjeroni rrugen sepse eshte burim aksidenti . Faleminderit paraprakisht.</p>	Sinaballaj	Te zgjidhura	3/7/2022	<p>Pershendetje,</p> <p>Z. ka paraqitur ankesen e tij ne platformen e bashkeqeverisjes ne muajin Nentor 2021 si vijon:</p> <p>(Ceshtja Nr 363568 ----- BURIM AKSIDENTI . Bashkia Rrogozhine , njesia administrative Sinabllaj . Hyrja e fshatit Sinabllaj eshte burim aksidenti per shkak te barrierave te vendosura qe nuk mund te shkembehin dy makina . Problemi dyte kur do hysh ne rruge interurbane pamje e keqe per shkak te pemeve dhe kallamave pa pastruar . (2204))</p> <p>Menjehere i eshte kerkuar kontraktorit te mirembajtjes te kryhet nderhyrja. Nga ana e Kontraktorit eshte pastruar vegjetacioni nderkohe, persa iu perket mbrojteseve metalik, guardrails, ata jane vendosur per te rritur sigurine rrugore dhe nuk mund te nderhyhet pasi cenohet kjo siguri.</p> <p>Sa i takon kerkese eventuale te z. Sula per zgjerimin e rruges, ju bejme me dije qe zgjerimi i rruges eshte "investim" dhe nuk mund te adresohet nga Projekti i mirembajtjes RRMSP, duke qene se ky projekt mbyllet me date 31.03.2022.</p> <p>Pune te mbare!</p>